

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuere, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorruption. Nëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencën të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorruption, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Prill, 2022

Komiteti Koordinator Antikorruption miraton Raportin e Monitorimit, vjetor 2021, të Planit të Veprimit Antikorruption

13.04.2022. Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, miratoi raportin e monitorimit vjetor 2021, të Planit të Veprimit Antikorruption. Viti 2021 ishte viti i 7-të i zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe i 3-të i Planit të Veprimit në fuqi. Ky raport monitorimi, jep një informacion të plotë dhe vlerësues mbi ecurinë e 18 objektivave specifike për të tre qasjet e politikave të parandalimit – ndëshkimit - ndërgjegjësimin kundër korrupsionit. Sektorët që kanë shënuar progres në këtë vit zbatimi 2021 janë transparenca e autoriteteve publik (95 autoritete publike përdorin e-regjistrer kërkesash dhe përgjigjesh) digitalizimi i shërbimeve elektronike (janë 1,212 e-shërbime në funksion të plotë), është rritur integriteti i nëpunësve publikë (12 varësitë e MD kanë miratuar plane integriteti), përmirësuar kontrolli i financave të partive politike (kryer 10 raporte auditimi financiare të partive politike), rritur bashkëpunimi dhe efica e organeve ligjzbatuese (SPAK-PP-Polici e Shtetit), shtuar ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me publikun kundër korrupsionit.

Raporti i Monitorimit vjetor, 2021 mund të aksesohet në këtë link: <https://www.drejtësia.gov.al/viti2021/>



Ministria e Drejtësisë vijon punën për hartimin e Strategjisë së re Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2023-2030

1-29.04.2022. Ministria e Drejtësisë ka vijuar intensivisht punën për hartimin e koncept-dokumentit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2023-2030. Grupi ministror i punës në bashkëpunim të ngushtë me ekspertizën teknike të Delegacionit Evropian në Tiranë (Projekti i Asistencës Teknike për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit) ka hartuar draftin e parë të koncept-dokumentit të ri, vizioni i të cilit pritet të jetë: Institucione publike që funksionojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike, dhe ofrojnë shërbime eficientë ndaj qytetarëve. Strategjia e re Kundër Korrupsionit do të ketë një qasje gjithëpërfshirëse (parandalim- mekanizma të ndëshkimit – ndërgjegjësim) dhe do të konfirmojë bashkëpunime institucionale të fushës. Procesi po kryhet në bashkërendim edhe me institucione të tjera si ministritë, organe të pavarura, organe të fushës ligjzbatuese me të cilat po konsultohet paraprakisht dokumenti. Së shpejti, Ministria e Drejtësisë do të nisë edhe zhvillimin e tryezave të hapura konsultimi të dokumentit.

Identi	Titulli	Statu	Shënime
1	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
2	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
3	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
4	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
5	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
6	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
7	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
8	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
9	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022
10	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030	koncept	13.04.2022

Të gjitha ministritë e linjës miratojnë plane integriteti; përmbushet rekomandimi 2 i GRECOs

29.04.2022. 10 ministritë e linjës kanë replikuar plotësisht eksperiencën e Ministrisë së Drejtësisë dhe kanë miratuar Planet institucionale të Integritetit, 2022-2025. 10 ministritë e linjës nën koordinimin direkt të Ministrisë së Drejtësisë dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizata të shoqërisë civile, IDM Albania, CSDG si dhe Misionin Pameca kanë përfunduar vlerësimin e riskut të integritetit dhe kanë hartuar dhe miratuar planet e integritetit me një kohëgjatje 4-vjecare. Këto instrumente antikorruptioni kanë marrë në konsideratë fusha specifike të veprimtarisë dhe të organizimit të këtyre institucioneve qendrore, ku fokusi kanë qenë fusha e transparencës, e burimeve njerëzore, menaxhimi financiar dhe i kontrollit të brendshëm si dhe kuadri rregullator i fushës. Miratimi i planeve të integritetit në të gjitha ministritë përmbush në këtë mënyrë edhe rekomandimin nr.2 të raportit të vlerësimit, raundi V, që GRECO i ka bërë Shqipërisë në vitin 2020, me afat prill 2022. Këto instrumenta integriteti janë një mjet i shtuar kontrolli i performancës institucionale, transparencës dhe llogaridhënies që autoritetet publike qendrore duhet të kryejnë dhe zbatojnë. Të gjitha Planet e Integritetit të ministrive janë të publikuara dhe mund të aksesohen direkt në faqet e internetit të secilës prej 10 ministrive.



Koordinatorët e Integritetit pranë varësive të Ministrisë së Drejtësisë fillojnë procesin e zbatimit të Planeve të Integritetit

6.04.2022. Ministria e Drejtësisë mbledh 12 Koordinatorët e Integritetit në të gjithë institucionet e varësisë së saj dhe kërkon zbatimin e Planeve të Integritetit. Me miratimin e këtyre instrumenteve të luftës kundër korrupsionit në të gjithë varësitë e Ministrisë së Drejtësisë në dhjetor 2021, dhe fillimin nga zbatimi të tyre, në përputhje me parashikimet kohore, koordinatorët e integritetit të emëruar u njohën me rolin dhe detyrat e tyre si ndjekës dhe garantues të zbatimit të planeve të integritetit pranë institucioneve të tyre. Qëllimi i këtij trajnimi ishte shpjegimi i procesit të monitorimit të këtyre instrumenteve, në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planeve të Integritetit në institucionet qendrore, në bazë dhe zbatim të të cilës do të mundësohen raportet e monitorimit të zbatimit të planeve të integritetit. Monitorimi do të bëhet mbi baza vjetore dhe do të shërbejë për të vlerësuar këto instrumenta si dhe progresin që ata do të sjellin në performancën institucionale. Trajnimi u mundësua në bashkëpunim me Projektin e Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.



Funksionarët politikë të kabinetit qeveritar trajnim për Kodin Etik Ministror dhe rregullat e integritetit

28.04.2022. Ministria e Drejtësisë në ushtrim të rolit të saj të institucionit lider për politikën antikorruption organizoi trajnimin për këshilltarët politikë pranë të gjithë kabineteve të ministrave, me temë: Menaxhimi i Etikës dhe Planet e Integritetit në Administratën Publike. Anëtarët e stafit politikë, drejtorë kabinetit dhe këshilltarë të 11 kabineteve ministrorë morën pjesë në seancën trajnim me fokus ndërgjegjësimin dhe informimin për çështje të integritetit në administratën publike, Planet e Integritetit dhe Kodin Etik Ministror. Kjo seancë trajnimi u krye në bashkëpunim me Projektin e Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, në fushën antikorruption dhe me Shkollën e Administratës Publike Shqiptare, si pjesë e komponentit të kurrikulës antikorruption. Kuadri ligjor për integritetin, rregullat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kodi Etik Ministror për funksionarët politikë si dhe angazhimi i tyre në kuadër të sigurimit të një performancë më të mirë të ministrive për më shumë transparencë dhe llogaridhënie ishin në vëmendje të këtij takimi.




Vijon zbatimi i "Kurrikula Antikorruption" në shkollat e arsimit të mesëm, Tiranë

11 – 12.04.2022. Projekti "Kurrikula antikorruption" në shkollat e mesme të Tiranës ka hyrë në fazën e 3-të të zbatimit të tij. Nxënësit e shkollave të mesme, "Petro N.Luarasi", "Qemal Stafa", "Asim Vokshi", "Myslym Keta" kanë zhvilluar seanca diskutimi dhe ndërveprimi me ekspertë të fushës antikorruption të organizatës "Avviso Pubblico" në Itali, partneri kryesor i këtij projekti për Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Katër takime në klasat e 4 shkollave ngjallën interesin e nxënësve për mënyrat sesi korrupsioni duhet denoncuar dhe kundërshtuar. Aplikimi i metodave proaktive kundër korrupsionit, si përmendet ushtrimi i mekanizmave në rastet kur iu kërkohet dhënia e rryshfetit, mosmarrja e shërbimit për këtë arsye, vonesat dhe kushtet në të cilat mund të ndodhen ata dhe familjarët e tyre ishin çështje të bashkëdiskutimit me nxënësit. Nxënësit u ftuan të jenë pjesë e projektit me prezantimin e ideve të tyre origjinale se si mund të kundërshtohet korrupsioni. Seanca përmblylëse e këtij projekti do të zhvillohet para përfundimit të vitit akademik 2021-2022.



Ministria e Drejtësisë fushatë ndërgjegjësimi kundër korrupsionit me studentët e Akademisë së Arteve

21.04.2022. Ministria e Drejtësisë, së bashku me përfaqësues të projektit të Asistencës Teknike, zhvilloi një takim ndërgjegjësimi dhe informimi në auditoret e Akademisë së Arteve, në Tiranë mbi rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Shqipëri. Zyrtarët pjesëmarrës theksuan rëndësinë që ka lufta ndaj korrupsionit përmes qasjes parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese. Ata u ndalën poashtu në shpjegimin e mekanizmave të denoncimit antikorrupsion, rastet e kontrollit, verifikimit dhe ndëshkimit të autorëve përgjegjës. Përmes punës dhe veprimtarisë së tyre krijuese, studentët e Akademisë së Arteve u ftuan të bëhen partnerë të luftës së përbashkët kundër korrupsionit, me krijimin e një përqsasjeje të re ndaj këtij fenomeni dhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit në komunitetet publike.



Ministria e Drejtësisë ndjek dhe informon për angazhimet antikorrupsion agjencitë homologe të rajonit

7 - 8.04.2022. Ministria e Drejtësisë në cilësinë e autoritetit përgjegjës për Antikorrupsionin mori pjesë në takimin e radhës së Grupit Drejtues të Iniciativës Rajonale Antikorrupsion (RAI), në Sofie, Bullgari. Iniciativat e përbashkëta rajonale kundër korrupsionit me efekte parandaluese siç përmendet deklarimi online i pasurive të funksionarëve publikë, bashkërendimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese antikorrupsion dhe koordinimi i nismave edhe me autoritete të tjera të fushës në rajon u diskutuan në këtë takim. Organizimi i Shkollës Verore Antikorrupsion për profesionistët e rinj të administratës, koordinimi i trajnimit për vlerësimin e riskut të korrupsionit në fushën e arsimit dhe të ndërmarrjeve publike dhe vlerësimi i hapësirave për korrupsion që mund të kenë ligjet e vendit, që pritet të zhvillohet në Maj, në Tiranë, ishin tema të rakordimit dhe partneritetit antikorrupsion me impakt të drejtpërdrejtë luftën antikorrupsion.

Më shumë informacion mund të gjeni gjithashtu në këtë link: <https://rai-see.org/37th-rai-steering-group-meeting/>

